# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-469861**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama në OKB: Shqipëria po ndërton një “pasqyrë dixhitale” kundër manipulimit dhe gënjeshtrave |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/rama-ne-okb-shqiperia-po-nderton-nje-pasqyre-dixhitale-kunder-manipulim-i588413` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 18:08:18 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 18:06:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ed7286041620c8d623f24bb8d81f08ae209dc891ed913cbb91ed65ff4bcad46e` |
| TEKSTI | `3e0775b4782376dcf007e3a021e74891e1f7823d49f52a86d186c9f91640b764` |
| PAMJA | `99bc75863b94aa962c0c155fcccc3ecd13b9e3ef96864192ab5e01ff2fdf584c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e515e2d21938a070d819b799a1c5e94a3b0ba4a3aa0300e7d7e99b405c9d5281` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b795f32e8dccad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e515e2d21938a070d819b799a1c5e94a3b0ba4a3aa0300e7d7e99b405c9d5281`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rama në OKB: Shqipëria po ndërton një “pasqyrë dixhitale” kundër manipulimit dhe gënjeshtrave

TemA
25 Shtator 2026, 20:06Politika TEMA



Duke u nisur nga debatet mbi debatet për kufizimin e inteligjencës artificiale, kryeministri Rama tha në OKB se Shqipëria është kundër këtij qëndrimi. Ai tha se nevojitet sovranitet dixhital që shtetet të ndërtojnë sisteme mbrojtjeje nga manipulimet.

Kryeministri u shpreh se kjo s’mund të jetë vetëm privilegj i vendeve të pasura pasi gënjeshtra udhëton kudo.

“Ne jemi kundër. Ne nuk mund të rregullojmë veten tonë deri në pafuqi. Për këtë pyetje, presidenti i SHBA-ve ka të drejtë, duhet të përshpejtojmë. IA në shërbim të qytetarëve, të përgjegjshme. Përgjigjja është kapacitet demokratik. Një inteligjencë sovrane artificiale do të thotë që asnjë vend të mos jetë i pafuqishëm para vendeve që s’mund t’i kuptojë. Çdo vend duhet të jetë i aftë të mbrojë gjuhën e vet, të zbulojë koordinimet e manipuluara dhe të informojë qytetarët pa u varur nga një korporatë e largët. Ja pse Shqipëria po ndërton një pasqyrë dixhitale mbështetur mbi IA. Pasqyra do të zbulojë strukturat e koordinuara, jo vetëm ato që shihen. Nuk do t’u thotë qytetarëve çfarë duhet të mendojnë. E drejta duhet të mbrohet haptazi. Pasqyra jonë ka për synim të shndërrohet në një infrastrukturë transparence, të mbrojë shoqërinë nga një industri gënjeshtrash. Qytetarët duhet të dinë kur përmbajtja politike me ndikim është gjeneruar artificialisht apo manipuluar. Arkitektura e shpërndarjes duhet të bëhet transparente, kush e krijoi apo shënjestroi. Shqipëria bën thirrje për një marrëveshje ndërkombëtare dhe për një inteligjencë artificiale sovrane. Sovraniteti dixhital s’mund të jetë privilegj i rezervuar për shtetet më të pasura. Gënjeshtrat udhëtojnë pa viza. Algoritmet i kapërcejnë kufijtë pa pasur nevojë për pasaportë”, tha Rama.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Berisha: Shqipëria ngjan me një të sëmurë në urgjencë, ripërtëritja e PD është jetike]

20:00 Politika

[VIDEO/Protestat, Rama nga OKB-ja: U fabrikua një narrativë për 'pushtimin izraelit' të bregdetit shqiptar, qytetarët protestuan kundër një fantazme]

19:50 Politika

Rama në OKB: Inteligjenca artificiale mund të fabrikojë realitetin sipas frikërave të qytetarëve

19:42 Politika

Sulmi me vezë i protestuesve ndaj Ramës, Balla: Emrat e tyre lidhen me histori shtëpish bari, u bëjnë hyzmet atyre që i paguajnë

19:15 Politika / 11 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.